



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE E MITROVICËS
OSNOVNI SUD U MITROVICU - BASIC COURT OF MITROVICA

C.nr.271/2012

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, departamenti I përgjithshëm (e vendosur në objektin e Degës së kësaj Gjykate në Vushtrri) , e përbër nga gjyqtari individual Faton Ademi me procesmbajtëse Elheme Peci, në qështjen juridike të paditësit: _____ nga _____ të cilin e përfaqson _____ nga _____ , kundër të paditurës: _____ të cilën e përfaqson Avokati Publik Komunal: _____ baza e kontestit: Vërtetim Pronësie, pas mbajtjes së seancës kryesore të datës: 06.02.2014, në prani të palëve ndërgjyqëse, gjykata me dt: 27.02.2014 nxjerr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. **APROVOHET** kërkespadia e paditësit : _____ kundër të paditurës _____ si e BAZUAR.
- II. **VËRTETOHET** se paditesi _____ është pronar në bazë të së drejtës së ndërtimit, i pjesës së ngastrës kadastrale _____ në sipërfaqe prej 60m2 ku është e vendosur shtëpia, ndërsa i njihet e drejta e shfrytëzimit të përhershëm e sipërfaqes prej 177 m2
- III. **OBLIGOHET** e paditura që t'ia njoh palës paditëse këtë të drejtë dhe t'ia mundësoj që të njëjtën ta regjistroj në regjistrat kadastral, në të kundërtën ky aktgjykim do të përmbrohet në mënyrë të dhunshme.
- IV. Secila palë i barë shpenzimet e veta procedurale.



Arsyetim

Paditësi me datë 06.11.2012 ka parashtruar në gjykatë padi për vërtetim pronësie, ku ka kërkuar nga gjykata që ta vërtetoj se paditësi është pronar i palujtshmërisë e cila gjendet në _____ dhe e cila evidentohet në emër të të paditurës sipas fletës poseduese nr.3300 në sipërfaqen që do të precizohet nga ekspertiza e cila do të pasojë gjatë procedurës, dhe e paditura është e obliguar që paditësit t'ia pranojë këtë të drejtë.

Në seancën e dt 08.01.2014 i autorizuari i paditësit deklaroj se mbetëm në tërsi pranë padisë dhe kërkespadisë.

Përfaqësuesi i të paditurës deklaroi: se _____ e kundërshtoj padinë dhe kërkespadinë, objekti i kontestit ka karakter të natyrës së regjimit të caktuar juridik të palujtshmërisë dhe duhet të trajtohet konform caktimit ligjor të kësaj natyre.

Gjykata ka mbajtur seancën kryesore në këtë qeshtje me datë: 06.02.2014, ku në këtë seancë i autorizuari i paditësit deklaroj: se mbetëm në tërsi pranë padisë dhe kërkespadisë së parashtruar, duke kërkuar nga gjykata që ta aprovoj në tërsi dhe ta vërtoj se paditësi është pronarë i pjesës së ngastrës kadastrale 700-0 në sipërfaqe prej 237m².

Përfaqësuesi i të paditurës deklaroi se mbetëm në tërsi si në procesverbalin e daljës në vend.

Në fjalën përfundimtare i autorizuari i paditësit deklaroi: bëjë precizimin e kërkespadisë, duke kërkuar nga gjykata të vërtëtohet se paditësi është pronar në bazë të së drejtës së ndërtimit në sipërfaqe prej 60m², ndërsa të vërtëtohet se të njëjtit i takon e drejta e shfrytëzimit për nevojat e palujtshmëris sipërfaqen prej 177m², shpenzimet e procedurës nuk i kërkoj.

I autorizuari i të paditurës në fjalën përfundimtare deklaroi se mbetëm në tërsi si në deklaratimet e mëhershme.

Në seancën kryesore u dëgjuan dëshmitarët : _____ dhe _____

Në procedure e administrimit të provav u lexuan këto prova: Ekspertiza gjeodete e datës 08.01.2014, qertifikata e pronësis me numër të mësis 73808130-00700-0, u shiqua kopja e planit e datës 13.01.2014, shëca e tërënit e datës 08.01.2014, fatura e mbeturinave në kopje dhe original e datës _____



08.07.1997, fatura e ujit në kopje dhe original e datës 09.10.1996, lexohet procesverbali I datës 08.01.2014.

Provat e administruara gjykata I vlersoj konform nenit 7 dhe 8 të LPK-së dhe pas bindjes së lirë erdhi në këto përfundime:

Nuk është kontestues fakti se paditësi e ka blerë pronën në fjalë pasi kjo vërtetohet nga dëshmia e dy dëshmitarëve dhe

ku kane deklaruar se kanë qenë dëshmitarë me rastin e blerjes së pronës në fjalë nga personi i quajtur ku paditësi i'a ka paguar te gjitha paratë në dorë dhe asnjëher nuk ka pasur penges rreth shfrytzimit të pronës në fjalë.

Gjykata me rastin e vlersimit te kredibilitetit të këtyre dëshmitarëve vendosi tua falë besimin e plotë deklaratave të këtyre dëshmitarëve, pasi që dëshmit e tyre përkojn me provat e ofruara nga paditësi.

Këtë e vërteton edhe më shum fakti se paditësi nuk ka qenë në dieni sa I përket kontestit , pasi që paditësi e shfrytzon këtë pronë qe nga vitet e 80-eta, dhe se paditësi më vonë ka ndërtuar shtëpi të re, gjithmon duke menduar se ajo është prona të cilën e kishte blerë nga personi I quajtur mirpo paditësi më von e ka kuptuar se prona në fjalë evidentohet në emër të të paditurës.

Nuk është kontestuese fakti se prona në fjalë gjendet në emer të të paditurës ku kjo vërtetohet nga qertifikata e pronësis me numër të njesis kadastrale

Gjykata sipas propozimit te paditësit ka dalë me ekspertin gjeodet në vendë.

Paditësi të drejtën e tij e mbështet në nenin 24 të Ligjit Mbi Marrëdhënjet Themelore Juridiko- Pronësore, që flet mbi të drejtën e ndërtimit si mënyr e fitimit të pronësisë.

Sipas Ligjit Mbi Mardhënjet Juridiko-Pronësore neni 24 thuhet si në vijim: "Personi që mundë të jetë bartës I të drejtës së pronësis, e që ndërton ndërtesën ose godinen tjetër (objektin ndërtimorë) në tokën mbi të cilën tjetri ka të drejtën e pronësis (ndërtuesi), fiton të drejtën e pronësis edhe mbi tokën mbi të cilën është ndërtuar objekti ndërtimo, si dhe mbi tokën e ndërtimit e domosdoshme për përdorimin e rregullt të këtij objekti ndërtimorë qe është



nuk ka ditur, as që ka mundur të dinte se po ndërton në tokën e huaj, kurse pronari nuk e ka kundërshtuar menjëher”.

Gjykata në rastin konkret do të aplikojë Ligjin e Mëhershëm pra Ligjin Mbi Marrëdhëniet Themelore Juridiko-Pronësore, meqenëse baza juridike është krijuar në kohën kur ai ligj ka qenë në fuqi, andaj aplikohet ai Ligj.

E paditura ka qenë e njoftuar , apo ka mundur të jetë se paditësi është duke e ndërtuar shtëpi në pronën në fjalë.

Palët në seancën e shqyrtimit kryesorë të datës 06.02.2014 deklaruan se hjekin dorë nga shpenzimet.

Gjykata konform nenit 450 të LPK-së vendosi si në dispozitiv sa i përket shpenzimeve të procedurës, pasi që asnjëra palë nuk i kërkuan shpenzimet procedurale.

Andai, gjykata konform nenit 143 par. 1 të LPK-së vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

C. nr.271/2012 të dt. 27.02.2014



UDHZIM MBI MJETIN JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi lejohet e drejta në ankesë, brenda afatit 15 ditor, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi. Gjykatës se Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.